



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universiteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar ipe dt. 07-04-2023	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-201

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 07.04.2023

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, duke u bazuar në Rregulloren mbi përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Bursave, Shpërblimeve dhe Formave tjera të mbështetjes financiare për studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, me nr. Prot. 01-197/A, të datës 11.05.2022, Këshilli Drejtues i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e dokumentacionit dhe ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2021 – 2022, në përbërje si në vijim:
 - 1.1 Prof. Ass. Dr. Sadik Maloku – Kryetar;
 - 1.2 Blerta Hajra Kabashi – anëtare;
 - 1.3 Andra Kycyku (Studente) – anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që të shqyrtojë të gjitha aplikacionet e studentëve për përfitim të bursës universitare në pajtim me Statutin e Universitetit, Rregulloren mbi përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Bursave, Shpërblimeve dhe Formave tjera të mbështetjes financiare për studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, me nr. Prot. 01-197/A, të datës 11.05.2022, dhe konkursin për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2021/2022.
3. Afati për shqyrtim të aplikimeve dhe shpallje të përfituesve duhet të jetë jo më shumë se 5 ditë pune.
4. Mandati i komisionit të lartcekur përfundon me rastin e publikimit të vendimit me listën e studentëve përfitues të bursës universitare.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'u dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Sekretarit të përgjithshëm;
- Zyrës së Personelit;
- Zyrës ligjore;
- Të përmendurve;
- Arkivit.

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Kryesues i Këshillit Drejtues

